

THE ISSUE OF AFFIXOIDS IN THE ALBANIAN LANGUAGE

PROBLEMI I SINDAJSHITESAVE NË GJUHËN SHQIPE

Selvije SELMANI'

*' Primary School "Simche Nastovski", Municipality of Jegunovce
e-mail: selmaniselvije@gmail.com***Abstract**

Word formation is one of the main areas of linguistic studies and aids in explaining the processes of word formation in a language. This research examines the status and function of affixoids in the word formation system of the Albanian language, focusing on Murat Isaku's works *The Unfortunates* and *The Apartment on the Third Floor*. In the linguistic literature, these units are treated in various ways: some researchers classify them as true prefixes, while others consider them as parts of compound words. To clarify this issue, this study analyzes the formations with the prefixes *krye-*, *bashkë-*, *gjysmë-*, *drejt-*, *kundër-*, and *vetë-*, comparing them with Albanian language dictionaries and research approaches to word formation.

The methods applied in this research include word formation analysis, comparison, and classification, enabling an examination of the process of word formation with prefixes. The analysis highlights the role of these units in constructing new meanings and their productivity in the lexicon of the Albanian language.

The results show that, although some researchers classify them as word-forming bases of compound words, the analyzed units function as productive prefixes in the word formation in the Albanian language. The research contributes to reconsidering the criteria for classification of affixoids, helping in the development of a more sustainable model for their analysis in the Albanian language.

Keywords: affixoids, prefixes, word formation, standard Albanian language, lexicon.

Abstrakt

Fjalëformimi është një nga fushat kryesore të studimeve gjuhësore dhe ndihmon në shpjegimin e proceseve të krijimit të fjalëve në një gjuhë. Ky hulumtim analizon statusin dhe funksionin e sindajshitesave në sistemin fjalëformues të shqipes, duke u përqendruar në veprat "Fatprerët" dhe "Banesa në katin e tretë" të Murat Isakut. Në literaturën gjuhësore, këto njësi fjalëformuese janë trajtuar në mënyra të ndryshme: disa studiues i klasifikojnë si parashtesa të mirëfillta, ndërsa të tjerë i konsiderojnë tema të fjalëve të përbëra. Për të sqaruar këtë çështje, në këtë punim analizohen formimet me parashtesat *krye-*, *bashkë-*, *gjysmë-*, *drejt-*, *kundër-* dhe *vetë-*, duke i krahasuar me fjalorët e shqipes dhe qasjet studimore mbi fjalëformimin.

Metodat e zbatuara në këtë studim përfshijnë analizën fjalëformuese, krahasimin dhe klasifikimin, të cilat mundësojnë analizën e procesit të formimit të fjalëve me parashtesa. Analiza nxjerr në pah rolin e këtyre njësive në ndërtimin e kuptimeve të reja dhe produktivitetin e tyre në leksikun e shqipes.

Rezultatet tregojnë se, ndonëse disa studiues i klasifikojnë si tema të fjalëve të përbëra, këto mjete fjalëformuese funksionojnë si parashtesa produktive në fjalëformimin e shqipes. Studimi kontribuon në rishikimin e kriterëve klasifikues për sindajshitesat, duke ndihmuar në përpunimin e një modeli më të qëndrueshëm për analizën e tyre në gjuhën shqipe.

Fjalë kyçe: sindajshitesa, parashtesa, fjalëformim, shqipe standarde, leksik.

Hyrje

Në këtë punim janë përfshirë formimet me parashtesat *krye-*, *bashkë-*, *gjysmë-*, *drejt-*, *kundër-* dhe *vetë-*, pra analiza dhe mënyra e formimit dhe funksioni i tyre në leksikun e shqipes. Për të sqaruar statusin e tyre, formimet e gjetura në romanet e Murat Isakut janë krahasuar me fjalorët e gjuhës shqipe dhe me përkufizimet e dhëna nga studiuesit e mëparshëm mbi sindajshtesat. Qëllimi i këtij studimi është të ndriçojë natyrën e këtyre njësive dhe të japë një kontribut në përcaktimin më të qartë të vendit të tyre në sistemin fjalëformues të shqipes. Duke qenë se në romanet e Murat Isakut nuk janë hasur formime me sindajshtesa sipas konceptit të Çepanit, ky studim përqendrohet tek parashtesat që kanë status të diskutueshëm në literaturën gjuhësore.

Në gjuhën shqipe lidhur me çështjen e sindajshtesave nuk ka një qëndrim të njëjtë nga gjuhëtarët. Ky studim synon të analizojë veçanërisht parashtesat *krye-*, *bashkë-*, *gjysmë-*, *drejt-*, *kundër-* dhe *vetë-*, për të përcaktuar nëse ato duhet të trajtohen si parashtesa të mirëfillta apo si sindajshtesa me status të ndërmjetëm. Në studimin e sistemit fjalëformues të shqipes disa i marrin si parashtesa, ndërsa të tjerët si pjesë të fjalëve të përbëra. Në Gramatikën e gjuhës shqipe, Morfologjia I, në grupin e siparashtesave pa përfunduar plotësisht të tilla përmenden: *drejt-*, *gjithë-*, *gjysmë-*, *jashtë-*, *plot-*, *shumë-*, *vetë-* (Agalliu, et al., 2002:187).

Gjuhëtari, Enver Hysa, në grupin e siparashtesave (prefiksoide) ose më saktë gjysmëparashtesave vështron elementet: *gjithë-*, *gjysmë-*, *ish-*, *jashtë-*, *krye*, *ndihmës-*, *plot-*, *zëvendës-*, *vetë-* (Hysa, 2004:60). Lidhur me këtë diferencim një qëndrim ndryshe mban gjuhëtari Paçarizi (2020:85), sipas të cilit parashtesat e tilla mund të jenë më të vonshme në shqipen, por kjo nuk i bën më pak parashtesa sesa parashtesat e tjera. Ai thekson se duke qenë semasiologjikisht të barabarta me parashtesat e tipit, *para-*, *prapa-*, *ndaj-*, *nën-*, *prej-* e ndonjë tjetër, ato që Hysa i quan siparashtesa në të vërtetë janë parashtesa për sa kohë që arrijnë të ndërtojnë paradigma kuptimore qartësisht të diferencuara.

Në grupin e siparashtesave gjuhëtari Jani Thomai llogarit parashtesat: *bashkë-*, *para-*, *prapa-*, *kundër-*, me të cilat formohen një tok emrash e foljesh me kuptime të ndryshme. Gjithashtu ai përmend se ka edhe një mendim, sipas të cilit *bashkë-*, *para-*, *prapa-*, *kundër-* etj. janë tema fjalësh, prandaj fjalët e formuara me to janë të përbëra (Thomai, 2002:156).

Sipas Anila Çepanit, sindajshtesat janë morfema me kuptim jo të qartë. Në varësi të pozicionit në fjalë, ashtu si edhe ndajshtesat, sindajshtesat ndahen në siparashtesa dhe siprapashtesa. Ajo përmend se ka dy konceptime për termin sindajshtesë. Njëri koncept i sheh sindajshtesat si elemente të kompozitave, të cilat, falë dendurisë së përsëritjes, priren të kalojnë në ndajshtesa (parashtesa ose prapashtesa). Ndërsa konceptimi i dytë i sheh sindajshtesat si përbërës të temës që nuk kanë kuptim të qartë (disa mund të kenë pasur kuptim dikur, por e kanë humbur), por që ndahen prej saj. Në leksikun e shqipes veçohen disa elemente që i plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si sindajshtesa. Në këtë grup studiuesja përmend: *curru* (currifit), *-bun* (kacabun), *kollo-* (kollofit), *kaca-* (kacagjel), *ka-* (kabisht), *-vit* (vërvit) *m-* (mbath), *n-* (ngarkoj), *gë(r)* (gërgas) etj., (Çepani, 2005:149).

Këtë grup fjalësh që kanë përpara fjalët *krye-*, *bashkë-*, *gjysmë-*, *drejt-*, *kundër-*, *vetë-*, ne i llogarisim fjalë të prejardhura me parashtesa sepse krijojnë struktura kuptimore të ndara qartë dhe të dallueshme.

Formimet me parashtesën krye-

Ndërtimet e me parashtesën *krye-*, që Hysa (1986:98) i quan *formime me siparashtesën krye-*, janë fjalë të përdorimit të përditshëm e të zakonshëm.

Parashtesa *krye-* është bashkuar me tema emërore duke krijuar emra, si: *kryemjeshtri*, *kryengritje*, *kryeqytet*.

kryemjeshtri (... *kryemjeshtri* me një bariton të gjallë këndonte që muret të mos shemben ...) (“Fatprerët”, f. 107).

kryengritje (... në ç’mënyrë e keni përgatitur *kryengritjen* antipopullore ...) (“Fatprerët”, f. 12).

kryeqytet (... ekspozita ime e pavarur me motive dimri nga *kryeqyteti* ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 77); (... e leja në stacionin automobilistik të Qytetit me Lumë për t’u kthyer në Bigë apo në *kryeqytet* ...) (“Fatprerët”, f. 211).

Formimet me parashtesën bashkë-

Parashtesa *bashkë-* në shqip, përveçse kuantifikuese, ka edhe një kuptim përcaktues. Kjo parashtesë i jep fjalës një saktësi kuptimore, duke e bartur kuptimin e vet në temën motivuese dhe duke e saktësuar atë. U përgjigjet parashtesave *ko-* dhe *kon-* (*co-* / *con-*) që nuk kanë arritur të bëhen prodhimtare në shqip, por kanë hyrë bashkë me temat përkatëse si fjalë të leksikalizuara, si kontemporan, koekzistencë etj., (Paçarizi, 2020:131).

Në prozën e Murat Isakut parashtesa *bashkë-* është bashkuar me emra të parmë, të prejardhur dhe me mbiemra.

Parashtesa *bashkë-* është bashkuar me një emër të parmë duke krijuar fjalën *bashkëshorte*.

bashkëshorte (... ju, një gjë të këtillë nuk do ta pranoni për *bashkëshorten* tuaj ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 196); (... „Moreja do të jetë *bashkëshortja* jote“ ...) (“Fatprerët”, f. 50).

Parashtesa *bashkë-* lidhet me emra të prejardhur me prapashtesat *-tar* dhe *-tor*, duke krijuar fjalët: *bashkëfshatar*, *bashkëmendimtar*, *bashkëpunëtor*, *bashkëudhëtare*.

bashkëfshatar (... këtë tërbim e kishte lidhur me shpifjet e një *bashkëfshatari* ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 99); (... hoqën të zitë e ullirit *bashkëfshatarët* e shkretë ...) (“Fatprerët”, f. 203).

bashkëmendimtar (... ai në bashkëpunim me *bashkëmendimtarët* e vet formon organizatën armiqësore ...) (“Fatprerët”, f. 220).

bashkëpunëtor (... edhe atë për të ma shtruar një pyetje: <<Cilët janë *bashkëpunëtorët* e tu, thuaj ç’vëpër armiqësore ke bërë ...>>) (“Fatprerët”, f. 12).

bashkëudhëtare (... e cila më ka besuar se do të bëhej bashkëshortja ime, *bashkëudhëtare* nëpër shtegtime ...) (“Fatprerët”, f. 183).

Parashtesa *bashkë-* lidhet me emra të prejardhur me prapashtesën *-im* dhe me mbiemra të prejardhur me prapashtesën *-or(e)*: *bashkëdyzim*, *bashkëpunim*, *bashkëkohor*, *bashkëtingullore*.

bashkëdyzim (... tek femra dashuria kuptohet si *bashkëdyzim* epshesh e jo zemrash ...) (“Fatprerët”, f. 217).

bashkëpunim (... një rrjet i tërë vendasish në *bashkëpunim* me një të huaj ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 217).

bashkëkohor (... në ç’masë gjen përkrahje kursi i civilizimit *bashkëkohor* ...) (“Fatprerët”, f. 301).

bashkëtingëllore (... pra, Rahmetullah me *bashkëtingëlloren* „H“ ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 130).

Parashtesa *bashkë-*, është bashkuar me emra të prejardhur me prapashtesën *-as*, *-ës*: *bashkëdorase*, *bashkëfolës*.

bashkëdorase (... a thua mund të ketë dorë apo të jetë *bashkëdorase* në zhdukjen e tij ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 218).

bashkëfolës (... më pak cyt nervin e *bashkëfolësit* ...) (Fatprerët, f. 12).

Formimet me parashtesën gjysmë-

Është parashtesë përcaktuese, funksionalisht e ngjashme me parashtesën *drejt-*, por sigurisht me ngarkesë të ndryshme semantike (Paçarizi, 2020:105).

Parashtesa *gjysmë-* është bashkuar me tema emërore dhe ka formuar emra dhe mbiemra. Me anë të kësaj parashtese janë formuar emrat: *gjysmëfjalë*, *gjysmëkapota*, *gjysmëterr*.

gjysmëfjalë (... më vraftë rrufeja nëse mora vesht **gjysmëfjale** ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 117).

gjysmëkapota (... **gjysmëkapota** bojë hiri me një sumbull mangut ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 162).

gjysmëterr (... përvidhte krahun në **gjysmëterr** me garuzhdën e çorbës ...) (“Fatprerët”, f. 13).

Me vlerë mbiemërore dalin ndërtimet: *gjysmëhungareze* dhe *gjysmëshqiptare*.

gjysmëhungareze (... duart e kësaj vajze gjysmëshqiptare, **gjysmëhungareze**, të ngrohta ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 72).

gjysmëshqiptare (... duart e kësaj vajze **gjysmëshqiptare**, gjysmëhungareze, të ngrohta ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 72).

Formimet me parashtesën drejt-

Parashtesa *drejt-* është bashkuar me një emër të prejardhur me prapashtesën *-im* dhe ka formuar emrin *drejtpeshim*.

drejtpeshim (... më mungon **drejtpeshimi** midis ndjenjës që ruaj ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 194); (... zemra më rrihte si çekan, kisha humbur **drejtpeshimin** ...) (“Fatprerët”, f. 64).

Formimet me parashtesën kundër-

Parashtesa *kundër-* buron nga parafjala *kundër*. Është një parashtesë prodhimtare në krijimin e emrave dhe mund të lidhet me emra, mbiemra dhe folje.

Parashtesa *kundër-* është bashkuar me tema emërore të prejardhura, si: *kundër + vënie*, *kundër + thënie*.

kundërthënie (... ajo mbi të gjitha është nënë, gjeneratore e mëkëmbjes së jetës, bukurisë, përsosmërisë, harmonisë midis **kundërthënieve** ...) (“Fatprerët”, f. 217).

kundërvënie (... atëherë pas **kundërvënies** me tërë fuqinë ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 32).

Në shqipen e sotme fjalët e formuara me parashtesën *kundër-* po vijnë duke u shtuar për shkak se kjo parashtesë i plotëson fare mirë funksionet e parashtesës me burim të huaj; prandaj disa fjalë që dikur përdorehin me parashtesën *anti-* tani përdoren vetëm me parashtesën *kundër-* (Samara, 2007:93).

Bashkimi i parashtesës *kundër-* me emrin e prejardhur me prapashtesën *-ar* ka formuar mbiemrin *kundërrevolucionar* (*kundër + revolucionar*).

kundërrevolucionar (... kanë përcjellë aktivitetin e saj **kundërrevolucionar** ...) (“Fatprerët”, f. 220).

Formimet me parashtesën vetë-

Në kohën e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, krijimi i fjalëve me përemrin *vetë-* ka shënuar një rritje të ndjeshme. Kjo ka sjellë numër të madh të fjalëve të reja, sidomos në terminologjitë e sotme të shqipes. Përdorimi i parashtesës *vetë-* në formimin e fjalëve ka bërë të mundur shprehjen e koncepteve dhe ideve të reja në një mënyrë të përshtatshme dhe të

përputhshme me kontekstin aktual shoqëror. Ky proces fjalëformues është bërë thelbësor për pasurimin e leksikut (Shehu, 1990:112).

Vetë- mund të bashkohet me tema emrash (potencialisht) të prejardhur pefoljorë (Shehu, 1989:152).

Me parashtesën *vetë-* në prozën e Murat Isakut kemi hasur ndërtimet:

a) *vetë* + emër i prejardhur me prapashtesën *-je*

vetë + *dashje*, *vetë* + *dije*, *vetë* + *vrasja*, *vetë* + *zhdukje*

vetëdashje (... kur e bëme më të butë nga shpina se barku, hoq me **vetëdashje** aureolën e „martirit“ ...) (“Fatprerët”, f. 300).

vetëdije (... s’ ishte nën kontrollin e **vetëdijes** sime ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 13); (... kohë pas kohe humbisja **vetëdijen** nga sulmi i nervave ...) (“Fatprerët”, f. 203).

vetëvrasja (...nga **vetëvrasja** hoqa dorë, por plagët mbetën të hapura ...) (“Banesa në katin e tretë”, f. 66); (... Lok Proka nga Biga, do të bënte vetëvrasje në qeli ...) (“Fatprerët”, f. 246).

vetëzhdukje (... që nga gjaku i vet ta flakë sindromin e **vetëzhdukjes** ...) (“Fatprerët”, f. 55).

b) *vetë* + emër i prejardhur me prapashtesën *-im*

vetë + *flijim*, *vetë* + *prezentim*

vetëflijim (... shkalla e gatishmërisë së **vetëflijimit** për të mirën e tjetrit ...) (“Fatprerët”, f. 218).

vetëprezentim (... i panjohuri (i Pari) sipas **vetëprezentimit**, Hasan Koka, më mbante në gjirin e vet ...) (“Fatprerët”, f. 169).

Përfundim

Analiza e formimeve me parashtesat *krye-*, *bashkë-*, *gjysmë-*, *drejt-*, *kundër-* dhe *vetë-* në veprat e Murat Isakut tregon se këto njësi funksionojnë si parashtesa produktive në sistemin fjalëformues të shqipes. Krahasimi me fjalorët dhe me studimet mbi fjalëformimin konfirmon se, ndonëse disa studiues i trajtojnë si elemente të fjalëve të përbëra, këto njësi kanë tipare funksionale të ngjashme me parashtesat e mirëfillta.

Rezultatet e këtij studimi sugjerojnë se është e nevojshme një rishikim më i strukturuar i klasifikimit të sindajshesave në shqipe. Një qasje më e qëndrueshme dhe e mbështetur në kriteret e qarta do të ndihmonte në përcaktimin e statusit të tyre në fjalëformimin e shqipes dhe në kuptimin më të mirë të proceseve fjalëformuese. Studimi tregon se njësitë e analizuara funksionojnë si parashtesa të mirëfillta dhe se klasifikimi i tyre si sindajshesa nuk mbështetet në materialin e vjelë.

Gjetjet e këtij studimi ndihmojnë në vendosjen e kriterëve më të qarta për klasifikimin e njësive fjalëformuese dhe japin një bazë për hulumtime të mëtejshme mbi zhvillimin e parashtesave në shqipen bashkëkohore.

Referencat

- [1]. Agalliu, F., & et al. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [2]. Çepani, A. (2005). Rreth problemit të sindajshesave në gjuhën shqipe. *Studime filologjike*, 3-4, 141-159.
- [3]. Hysa, E. (1986). Sindajshesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe. *Studime filologjike*, 2, 91-100.
- [4]. Hysa, E. (2004). *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*. Tiranë: Mësonjëtorja.
- [5]. Paçarizi, Rr. (2020). *Fjalëformimi ndajshesor i shqipes*. Prishtinë: Armagedoni.
- [6]. Samara, M. (2007). Rreth zhvillimit të leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe. *Studime filologjike*, 1-2, 83-110.
- [7]. Shehu, H. (1989). Rreth sindajshesave (afiksoideve) në gjuhën e sotme shqipe. *Studime filologjike*, 2, 145-153.

- [8]. Shehu, H. (1990). Formime me gjymtyrë të parë temën përmërore vetë- në gjuhën e sotme letrare shqipe. *Studime filologjike*, 3,112-125.
- [9]. Thomai, J. (2002). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë.